

VENDIM
Nr.451, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 34 të ligjit nr.8869, datë 21.3.2002 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 11 e 26, pika 1, të ligjit nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, që përmendet në pikën 1 të vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Niveli i pagës për gradë sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficer	Madhor	Gjeneral garde
	I lartë	Kolonel
		N/Kolonel
		Major
	I mesëm	Kapiten
		N/Kapiten
	I ulët	Toger
		N/Toger
Për punonjësit nënoficer	Madhor	Kryekapter
	I lartë	Kapter
		Kapter shtabi
		Kapter mjeshtër
	I mesëm	Kapter i parë
		Kapter i dytë
		Kapter i tretë
	I ulët	Kapter i katërt
		Rreshter